



Planuar / Dorezuar Primitje/Prodato Received/Delivery	17 - 08 2023	3	viti god year
Organ./Njësia Org./Jedinstva Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSKICK	5711/2023		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.907/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare Arben Mehmeti, dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.907/2023 të datës 04.07.2023 të ankuesit [redacted] të cilin më autorizim e përfaqëson Avokati [redacted] me adresë rruga " [redacted] " në Prishtinë, kundër Vendimit KA.Nr.22/23 të datës 06.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.907/2023 e datës 04.07.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Shfuqizohet Vendimi KA.Nr.22/23 i datës 06.06.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- III. Obligohet Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të bëjë zbatimin e këtij vendimit, të bëjë rishqyrtimin e këtij rasti.





IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi të bëhet si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja, [REDACTED], punësuar në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës sipas Akt Emërimit Nr. protokollit ZBNJ/DP-057/2013 të datës 01.07.2013 në pozitën „Zyrtare e Larte për Bazë të Dhënave” në Njësinë për Shqyrtimin e Performances se Prokurorive-NjSHPP më datë 02.02.2023 U.D e Drejtorit të Njësisë për Shqyrtimin e Performances se Prokurorive-NjSHPP përmes e-mailit njofton gjithë vartësit e saj përfshirë edhe ankuesen lidhur me klasifikimin e pozitave të punës sipas koeficientit, ku në mënyrë tabelare pozita e ankueses është klasifikuar në profesional 1 me koeficient 5.85. Ankuesja për muajin shkurt dhe mars 2023 është paguar me koeficient të pagës 9.4, ndërsa nga muaji prill 2023 është paguar me koeficient të pagës 5.85, kështu që më datë 02.05.2023 ankuesja përmes e-mailit ka kërkuar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore që të njoftohet se si është bërë zbritja e koeficientit. Ndërsa kjo e fundit me të njëjtën datë i është përgjigjur ankueses se Këshilli Prokurorial i Kosovës me date 19.01.2023 ka marr vendim për klasifikimin e pozitave të punës ndërsa me datën 30 Mars 2023 nga Ministria e Financave dhe Transfereve, përkatësisht Thesari i Kosovës kemi pranuar një njoftim se deri me muajin Shtator të këtij viti lëshimet eventuale rreth pagave, do të korrigjohen.

Ankuesja më datë 10.05.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 06.06.2023 ka nxjerr Vendim KA.Nr.22/2023 me të cilin vendim e ka hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e datës 10.05.2023 të parashtruar nga ankuesja.

Ankuesja kundër Vendimit KA.Nr.22/23 të datës 06.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 04.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5010/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 13.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 5010/2023 të datës 04.07.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën e datës 10.05.2023 të parashtruar



nga ankuesja në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës; Emalin e datës 05.05.2023 të R.Statovci drejtuar B. [REDAKTUAR] Emalin e datës 02.05.2023 të R. [REDAKTUAR] drejtuar B. [REDAKTUAR]; Listën e pagave për muajin Janar- 2023; Vendimin me numër Ka.nr.22/2023 të datës 06.06.2023; Aktin e emërimit me numër ZBNJ/DP-057-2013 të datës 01.07.2013; Vendimin me numër 04/128 të datës 16.02.2023; Listën pagave për muajin Janar-2023; Listën pagave për muajin shkurt-2023; Listën e pagave për muajin Mars-2023; Listën pagave për muajin Prill-2023; Listën e pagës të nxjerr nga llogaria personale; Emalin e datës 05.05.2023 të B. [REDAKTUAR] drejtuar I. [REDAKTUAR] Emalin e datës 05.05.2023 të B. [REDAKTUAR] drejtuar I. [REDAKTUAR] Emalin e datës 05.05.2023 të I. [REDAKTUAR] drejtuar B. [REDAKTUAR]; Emalin e datës 04.05.2023 të A. [REDAKTUAR] drejtuar I. [REDAKTUAR]; Emalin e datës 03.05.2023 të I. [REDAKTUAR] drejtuar A. [REDAKTUAR]; Emalin e datës 02.05.2023 të I. [REDAKTUAR] drejtuar B. [REDAKTUAR] Emalin e datës 03.05.2023 të B. Luzha drejtuar I. [REDAKTUAR] emalin e datës 02.05.2023 të [REDAKTUAR] drejtuar I [REDAKTUAR]; Emalin e datës 02.05.2023 të [REDAKTUAR] drejtuar [REDAKTUAR]; Emalin e datës 02.05.2023 të [REDAKTUAR] drejtuar [REDAKTUAR] Emalin e datës 02.05.2023 të [REDAKTUAR] drejtuar [REDAKTUAR]; Emalin në datës 02.02.2023 të [REDAKTUAR] drejtuar [REDAKTUAR] Emalin e datës 02.05.2023 të [REDAKTUAR] drejtuar B. [REDAKTUAR] Emalin e datës 02.05.2023 të [REDAKTUAR] drejtuar [REDAKTUAR] Emalin e [REDAKTUAR] drejtuar [REDAKTUAR]; Emalin e datës 02.05.2023 të [REDAKTUAR] drejtuar [REDAKTUAR] Emalin e datës 07.07.2023 të [REDAKTUAR] drejtuar [REDAKTUAR]; Emalin e datës 02.02.2023 të [REDAKTUAR]; Listën lidhur me kategorizimin e pozitave; Autorizimin e datës 15.06.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.6.2023; Përgjigjeni në ankesë të datës 13.07.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet *në rishqyrtim dhe rivendosje* të organi i njëjtë, *sepse*:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.22/23 të datës 06.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në mënyrë të gabuar ka konstatuar se ankesa është e pasafatshme, ngase ankuesja asnjëherë nuk është njoftuar për vendimin lidhur me klasifikimin e koeficienteve, dhe ankuesja nuk ka marr asnjë njoftim zyrtar përveç një emaili replay nga znj. I.M, U.D e Drejtorit të Njesisë për Shqyrtimin e Performances se Prokurorive-NjSHPP; po ashtu emali i datës 02.02.2023 nuk kishte asnjë informacion në lidhje me mjetet juridike.

Kolegji i Këshillit, marr për bazë provat materiale të lëndës, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuses, po ashtu ka shqyrtuar edhe ligjshmërinë e Vendimit KA.Nr.22/23 të datës 06.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, konstaton se siç pretendohet edhe në përgjigjen në ankesë të dërguar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës se Këshilli Prokurorial i Kosovës më datë 19.01.2023 ka nxjerr vendim për klasifikimin e pozitave të stafit administrativ, mirëpo në bazë të dëshmimeve të lëndës, ankuesja nuk është njoftuar asnjëherë lidhur me këtë vendimmarrje, për më tepër më datë 02.02.2023 Udhëheqësja e Burimeve Njerëzve në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës ka njoftuar vetëm stafin udhëheqës të këtij



institucioni lidhur me klasifikimin e pozitive në këtë institucion, mirëpo nuk ka njoftuar ankuesen për ndryshimet lidhur me këtë klasifikim, ndërsa ankueses të njëjtën ditë emaili i datës 02.02.2023 i është dërguar nga znj. I.M, U.D e Drejtorit të Njesisë për Shqyrtimin e Performances se Prokurorive-NjSHPP me titullin *"për njoftimin e juaj, shih e-mailin"*.

Në bazë të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht me nenin 3 paragrafi 2 është përcaktuar se: *"2. Procedura administrative është tërësia e renditur sipas ligjit e veprimeve procedurale dhe materiale të njëpasnjëshme të organit publik, që ka për qëllim përgatitjen dhe vendimmarrjen për një veprim konkret administrativ, shqyrtimin e mjeteve juridike administrative, si dhe ekzekutimin e aktit administrativ"*, me nenin 9 paragrafi 2 është përcaktuar se: *"2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj"*, me nenin 51 paragrafi 1, është përcaktuar se: *"Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij"*, rrjedhimisht bazuar në dispozitat e cekura më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se institucioni punëdhënës ka qenë i obliguar që përmes personave përgjegjës t'i njoftoj palë lidhur me këtë vendimmarrje.

Duke marr parasysh faktin se ankuesja për muajin shkurt dhe mars 2023 është paguar me koeficient 9.4 ndërsa për muajit e tjera më koeficient 5.85, atëherë sipas Kolegjit të Këshillit, duke ju referuar edhe dispozitave ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ankueses e drejta për procedimin administrativ respektivisht e drejta për ankimim i ka lind në kohën kur paga e tij në muajin prill është proceduar me koeficientin 5.85, rrjedhimisht sipas Kolegjit të Këshillit, meqë njoftimi i datës 02.02.2023 nuk ka përmbajtur asnjë udhëzim juridike mbi mjetet juridike atëherë sipas nenit 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *"3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj"*, andaj në këtë rast nuk mund të konsiderohet që janë shkelur afatet për ankimim, ngase ankuesja ka filluar këtë procedim përmes kërkesës së datës 02.05.2023.

Duke marr parasysh të faktet e lartcekura, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.Nr.22/23 të datës 06.06.2023, nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendje faktike lidhur me afatshmërinë e parashtrimit të ankesës nga ana e ankueses, gjegjësisht Komisioni nuk ka marr për bazë asnjë nga rrethanat juridike dhe faktike të rastit por vetëm ka vendosur lidhur me afatshmërinë e ankesës së ankueses, andaj si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi KA.Nr.22/23 i datës 06.06.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, është nxjerr në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ngase ankesa e ankueses është e



afatshme, kështu që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës është i obliguar në që të rishqyrtoj ankesën e datës 10.05.2023 të ankueses dhe në ri procedurë të mënjanojë shkeljet procedurale duke i shqyrtuar të gjitha pretendimet e ankueses dhe varësisht nga provat materiale të vendos në pajtim me legjislacionin për nëpunësit civil dhe dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër, A.nr.907/2023

**Ilire MEHMETI-SHAQIRI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit.
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.